



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 07, Datë 27.07.2022

**PËR**  
**SHPLLJEN E ZONËS SË RËNDËSISË KOMBËTARE NË PLANIFIKIM,**  
**MIRATIMIN E KUFIJVE TË ZONËS SË MBROJTUR DHE ZONIMIT TË**  
**BRENDSHËM TË EKOSISTEMIT NATYROR DETAR-BREGDETAR TË GJIRIT**  
**TË PORTO PALERMO "PARK NATYROR"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, nenit 10, 12 dhe 13 të Ligjit Nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura", të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me kërkesë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Shpalljen si zonë e rëndësisë kombëtare në planifikim të Ekosistemit Natyror Detar-Bregdetar të Gjirit të Porto Palermo "Park Natyror".
2. Miratimin e kufijve të zonës së mbrojtur dhe zonimit të brendshëm të:
  - Ekosistemit Natyror Detar-Bregdetar të Gjirit të Porto Palermo "Park Natyror".
3. Pezullimin e dhënies së lejeve të reja të zhvillimit/ ndërtimit si dhe pezullimin e planeve të detajuara vendore në territorin administrativ në të cilin përfshihet Ekosistemi Natyror Detar-Bregdetar i Gjirit të Porto Palermo "Park Natyror", deri në shpalljen e zonës së mbrojtur mjedisore nga Këshilli i Ministrave.
4. Deri në shpalljen e zonës së mbrojtur mjedisore nga Këshilli i Ministrave, autoritetet e zhvillimit të territorit lejohen të japin leje zhvillimi/ ndërtimi në territorin administrativ në të cilin përfshihet Ekosistemi Natyror Detar-Bregdetar i Gjirit të Porto Palermo "Park Natyror", vetëm pasi të kenë marrë konformitet nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, për këto raste përjashtimore:
  - Punime mirëmbajtje;
  - Leje zhvillimore për interes publik, shtetëror ose kombëtar.



Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë:

- Harta e kufijve të zonës së mbrojtur;
- Kufijtë elektronik, në format vektorial të zonës së mbrojtur (CD).

6. Ngarkohen Bashkia Himarë, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe autoritetet e tjera të zhvillimit të territorit për ndjekjen dhe zbatimin e pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi.
7. Zonat e mbrojtura mjedisore, janë zona të rëndësisë kombëtare në planifikim dhe janë subjekt i planifikimit kombëtar sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
8. Gjatë hartimit të planeve sektoriale, planeve të detajuara për zona të rëndësisë kombëtare, planeve sektoriale në nivel qarku, planeve të përgjithshme vendore, projekteve strategjike dhe pilot të zhvillimit, si dhe të tjera të ngjashme me to, autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit në nivel qendror, qarku dhe atë vendor, duhet të bazohen në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga përcaktimet e këtij vendimi, si dhe pasi të ketë hyrë në fuqi vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave që e shpall të mbrojtur zonën mjedisore të përcaktuar në pikën 1.
9. Çdo dokument planifikimi në fuqi, që bie ndesh me këtë vendim, duhet të ndryshohet në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi, pasi të ketë hyrë në fuqi vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave që e shpall të mbrojtur zonën mjedisore, të përcaktuar në pikën 1.
10. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkia Himarë, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, si dhe të gjitha Autoritetet e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit që përfshihen në këtë zonë për zbatimin e këtij vendimi.
11. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT  
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

